

Protokoli i pjesëmarrjes së nxënësve: Referencë e shpejtë

Sipas ligjit të Pensilvanisë, të gjithë nxënësit e moshës gjashtë (6) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç duhet të shkojnë në shkollë çdo ditë. Pasi nxënësit regjistrohen në shkollë, përfshirë nxënësit në kopsht, ata janë subjekt i këtij ligji deri në moshën 18 vjeç.

Përkufizime

- 3 mungesa e lart pa arsye = Nxënës që mungon pa arsye
- 6 mungesa e lart pa arsye = Nxënës që zakonisht mungon pa arsye
- 10 mungesa e lart pa arsye = Nxënës që mungon pa arsye në mënyrë të vazhdueshme



Gjysmë dite

- Nga kopshti deri në klasë të 8: Një nxënës që vjen në shkollë dy (2) orë pas nisjes së mësimi ose largohet dy (2) orë para mbarimit të mësimi, do të marrë mungesë për gjysmën e ditës.*
- Shkollat e vërteta tetëvjeçare (që kanë vetëm klasat 6-8) dhe shkollat e mesme: Nxënësit nuk marrin mungesë për gjysmën e ditës. Nxënësit janë të koduar siç duhet sipas klasës/periudhës mësimore.

**Nëse fëmija ka një shënim nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor (mjek, dentist, psikolog, psikiatër etj.) ai do të shënohet si i justifikuar për gjysmën e ditës (paradite ose pasdite). Shënimi duhet t'i jepet shkollës pas kthimit nga ofruesi i kujdesit mjekësor brenda 24 orëve nga vizita. Nëse nxënësi nuk ka një shënim, gjysma e ditës do të mbetet e pajustificuar.*

Vonesat (Ditët në të cilat nxënësit paraqitet me vonesë NUK llogariten si mungesa)

- Nga kopshti deri në klasë të 8: Një nxënës që vjen në shkollë pasi ka filluar mësimi, por më pak se dy (2) orë pas fillimit të mësimi, do të konsiderohet me vonesë.
- Shkollat e vërteta tetëvjeçare dhe shkollat e mesme: Kur një nxënës vjen me vonesë, nuk skanohet por shkon direkt në klasë. Mësuesi do ta shënojë nxënësit si me vonesë për klasën/periudhën mësimore.

Nëse një nxënës ka një justifikim me shkrim nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor, kjo do të llogaritet si një vonesë me arsye.

Largimi më herët (Largimet më herët NUK llogariten si mungesa)

- Nëse një nxënës largohet nga shkolla në çdo kohë gjatë ditës, jashtë parametrave të caktuara në procedurën e mungesës gjysmë dite/vonesës, rasti do të shënohet si largim më herët pa leje.*

**Nëse nxënësi ka një justifikim me shkrim nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor, ai do të shënohet si i larguar më herët me leje. Justifikimi duhet të dorëzohet brenda 24 orëve nga largimi i nxënësit nga shkolla që mungesa të konsiderohet e justifikuar.*

Njoftim nga prindi për mungesën (Shënim me shkrim)

- Sipas rregullores së rrethit lidhur me pjesëmarrjen, duhen paraqitur shënime me shkrim në të cilat shpjegohet.
 - Kontaktoni shkollën e fëmijës për të verifikuar mënyrat se si mund të dorëzohen justifikimet me shkrim.
 - Justifikimet duhet t'i jepen shkollës brenda **tre (3) ditëve** nga rikthimi i nxënësit në shkollë. Nëse justifikimi nuk dorëzohet në shkollë brenda harkut të kërkuar kohor, ditët mund të mos justifikohen.
 - Te shënimet me shkrim duhet të tregohet emri i studentit, data ose datat e mungesave dhe një

numër telefoni i vlefshëm ose mënyra të tjera kontakti për qëllime verifikimi.

- Të gjitha mungesat që rezultojnë në një total prej tre (3) ose më shumë ditësh të njëpasnjëshme për shkak të sëmundjes, do të kërkojnë një justifikim me shkrim nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor.
Justifikimi nga një ofrues i kujdesit shëndetësor mund të dorëzohet në vend të një justifikimi nga prindi për çdo mungesë.
- Për të gjitha mungesat dhe ato që nuk kanë një total prej tre (3) ditësh të njëpasnjëshme, prindërit mund të dorëzojnë një justifikim me shkrim duke përmendur arsyen e mungesës.
- Kur një nxënës ka munguar për shkak të sëmundjes, të justifikuar me një shënim nga prindi, për tetë (8) ditë (gjithsej), të gjitha mungesat e mëpasshme mund të kërkojnë një justifikim me shkrim nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor.

**Dorëzimi i shënimeve nuk do të thotë medoemos që mungesat justifikohen në mënyrë automatike, por ato do të rishikohen nga shkolla për të përcaktuar nëse janë të vlefshme.*